



Pranuar / Dorezuar Priljepra / Predato Received / Delivered	02.12.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5780/2021		1/9

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.900/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.900/2021 të datës 03.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga „ Prekazi”, nr.27 lagja e Spitalit, nga Komuna e Prishtinës, sipas Aktgjykimit A. Nr. 373/2020, të datës 28.10.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative. kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kompensimi material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.12.2021, mori këtë.

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.900/2021 e datës 03.11.2021, e parashtruar nga ankuesi sipas Aktgjykimit A.nr. 373/2020, të datës 28.10.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

**SHFUQIZOHET**, shkresa e datës 29.01.2020, e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, e Administratës Tatimore të Kosovës.

**MBETET NË FUQI**, Vendimi i datës 09.01.2020, me numër 11, i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 05.02.2020, me numër protokoll 286/2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 09.01.2020, nr.11, të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës



Tatimore të Kosovës, me pretendimin ankimor se me rastin e pensionimit organi punëdhënës duhet ti paguaj 3 paga ashtu siç e përcakton Kontrata Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.02.2020, me numër protokolli 340/2020, ka njoftuar ankuesin se nuk mundë të shqyrtohet dhe vendos lidhur me ankesën A.nr. 24/2020, të datës 13.02.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesi që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 13.02.2020, me datë 28.02.2020, ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.10.2021, A.nr. 373/2020, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 13.02.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr. 24/2020, të datës 05.02.2020 të ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 900/2021 të datës 03.11.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas Aktgjykimit A. Nr. 373/2020, të datës 28.10.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimi Nr. 373/2020 i datës 28.10.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative: Ankesën A. Nr. 24/2020 e parashtruar më datë 05.02.2020 me numër protokolli 2862020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 27.01.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vërtetim i datës 28.01.2020; Vendim i datës 08.01.2020; Akt Emërimi i datës 27.03.2013; Aktgjykimi i datës 19.12.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi i datës 04.02.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; dëshmi nga banka; Vendimi i datës 09.01.2020;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit

**është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 09.01.2020 ka nxjerr vendimin nr.11, lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të ankuesit, duke i njohur të drejtën e një pagë pas arritjes së moshës së pensionimit.





Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit Jakup Shaqiri, i cili pretendon së organi i punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, duhet të bëjë pagesën e tri (3) pagave me rastin pensionimit, sipas Kontratës Kolektive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar provat e lëndës konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar, sepse për kompensimet e nëpunësit civil janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe aktet të tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civilë me rastin e pensionimi ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme e jo tri (3) pagave siç ankuesi ka pretenduar kjo parashihet me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: Paragrafi 1. **“Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”** dhe paragrafi 2. **“Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”**.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar së Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, ka nxjerr vendimin e datës 09.01.2020 me numër protokoll 11, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin i njeh të drejtën e një pagë të fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe i njëjti është në pajtim nenin 19, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores 33/2012, për Shtesat në pagë dhe kompensimet të tjera të nëpunësve civil, ku thuhet se: **Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civil , nëpunësi civil që arrin moshën e pensionimit në shërbimin civil. gëzon të drejtën e kompensimit, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit , gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të menjëhershme në vlerën e pagës së fundit.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”**, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: **“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”**, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: **“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”**, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.



Prandaj Kolegji duke u nisur nga ajo që u tha më lartë merr si rrethanë faktike dhe ligjore lidhur me refuzimin e ankesës faktin se në kohën kur është pensionuar ankuesi nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive dhe si rrjedhojë nuk ka efekte juridike, prandaj ankuesi pretendimin e tij e ka bazuar në një marrëveshje ose akt juridik i cili nuk është në fuqi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.900/2021

Rushit Kajtazi



Procesmbajtës

Eshref SHABANI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjyqtarit GJTH-Prishtinë
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

